



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
MINISTRI

Nr. 1733 Prot.

Tiranë, më 27.02. 2026

URDHËR

Nr. 58, datë 27.02. 2026

PËR

**LIRIMIN NGA DETYRA TË ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË  
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË  
ANËTARËVE TË RINJ PËRFAQËSUES TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR  
ARSIMIN**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 48, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimit nr.782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë",

URDHËROJ:

1. Lirimin nga detyra të anëtarëve të Bordit të Administrimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si më poshtë:
  - a) Znj. Mirela Bimo;
  - b) Z. Fatjon Dhuli, si anëtar i përkohshëm.
2. Emërimin në detyrë të anëtarit të Bordit të Administrimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si më poshtë:
  - a) Znj. Ledina Agalliu
3. Emërimin e znj. Jona Suli, si anëtar i përkohshëm deri në përzgjedhjen e përfaqësuesit të studentëve në Universitetin Politeknik të Tiranës.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Universiteti Politeknik i Tiranës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

